



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 197

Tiranë – E premte, 24 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 603, datë 23.10.2025	Për lirim nga detyra..... 24067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 23.10.2025	Për emërim në detyrë..... 24067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 23.10.2025	Për emërim në detyrë..... 24067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 607, datë 23.10.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitim, rikonstruksion i urës së Viroit”..... 24067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 23.10.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugës ‘Kujtim Laro’ dhe ‘Kongresi i Manastirit’, Bashkia Tiranë”..... 24069
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 23.10.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 24071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 23.10.2025	Për përcaktimin e rregullave, masës, përjashtimeve nga sanksionet dhe procedurës për mbledhjen dhe administrimin e tarifës së transmetimit të informacionit të udhëtimit..... 24071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 23.10.2025	Për lirim nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit..... 24073



VENDIM
Nr. 603, datë 23.10.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 604, datë 23.10.2025

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Elda Xhumari emërohet zëvendësministër i Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 605, datë 23.10.2025

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të

Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Herida Duro emërohet zëvendësministër i Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 607, datë 23.10.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIM, RIKONSTRUKSION
I URËS SË VIROIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitim, rikonstruksion i urës së Viroit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “vresht”, me një vlerë të përgjithshme prej 700 000 (shtatëqind mijë) lekësh.

4. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit prej 700 000 (shtatëqind mijë) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.



5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë

për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTTT
“REHABILITIM/RIKONSTRUKSION I URËS SË VIROIT”

Nr. rendor	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë				Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m ²)	Shpronësim tokë “vreshtë”			Vlerësimi kultura bujqësore /drufrutore (lekë)		
								Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)			
1	Mihal	Sofo	Ciko	8541	110/1	Vresht	1000	41	6000	246,000	106,000	352,000	
2	Arben	Muharrem	Zhupa	8541	110/2	Vresht	1000	42	6000	252,000	66,000	318,000	
3	Sadik	Maliq	Koteli	8541	110/3	Vresht	1000	5	6000	30,000		30,000	
Vlera totale												700,000	

**VENDIM****Nr. 608, datë 23.10.2025**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I HAPËSIRËS SË
PALLATEVE NË KRYQËZIMIN E
RRUGËS ‘KUJTIM LARO’ DHE
‘KONGRESI I MANASTIRIT’,
BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugës “Kujtim Laro” dhe “Kongresi i Manastirit”, Bashkia Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 6 055 283.97 (gjashtë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 6 055 283.97 (gjashtë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekësh përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

NR. RENDOR	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (Kufizime hipotekore barre mbi pasurinë etj.)
													“TRUALL”			“NDËRTESE”				
	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	QYTETI	ZONA KADASTRALE	NR. I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	VOLUM	FAQE	SIPËRFAQJA (m2)	ÇMIMI (Lekë/m²)	VLERA (lekë)	SIPËRFAQJA (m²)	ÇMIMI (Lekë/m²)	VLERA (lekë)		
1	AFERDITA	-	SHEGA	TIRANE	8140	3/27	TRUALL	90.12	90.12	0	21	84	90.12	35,199.00	3,172,133.88					
	ANILA	-	KAMBERI																	
	BEDRI	-	KULLAKSHI																	
	DHURATA	-	KULLAKSHI																	
	FATBARDHA	-	BAKLAVA																	
	FLUTURA	-	KUSI																	
	HALIL	-	KULLAKSHI																	
	LILJANA	-	ISMAILI																	
	MAHMUDE	-	KULLAKSHI																	
	MYZEJEN	-	IBRAHIMI																	
	SAFUE	-	KULLAKSHI																	
	SHPETIM	-	KULLAKSHI																	
	SHQIPE	-	BIÇAKU																	
	VALBONA	-	KULLAKSHI																	
	XHELAL	-	KULLAKSHI																	
	ZAIDE	-	KULLAKSHI																	
	AFERDITA	RIFAT	SHEGA																	
	BEDRI	SEFER	KULLAKSHI																	
	DHURATA	SEFER	NJOLRI																	
	FATBARDHA	RIFAT	BAKLAVA																	
	HALIL	SEFER	KULLAKSHI																	
	IBRAHIM	SEFER	KULLAKSHI																	
	OSMAN	SEFER	KULLAKSHI																	
	SAFIE	SALI	MYRTAJ																	
	SHQIPE	RIFAT	BIÇAKU																	
	XHELAL	SEFER	KULLAKSHI																	
	AFERDITA	RIFAT	SHEGA																	
	BEDRI	SEFER	KULLAKSHI																	
	FARTBARDHA	RIFAT	BAKLAVA																	
	HALIL	SEFER	KULLAKSHI																	
SHQIPE	RIFAT	BIÇAKU																		
XHELAL	SEFER	KULLAKSHI																		
ANILA	-	KAMBERI																		
DHURATA	-	KULLAKSHI																		
FATMIR	-	KULLAKSHI																		
FLUTURA	-	KUSI																		
LILJANA	PERPARIM	ISMAILI																		
MAHMUDE	-	KULLAKSHI																		
MYZEJEN	-	IBRAHIMI																		
SAFUE	-	KULLAKSHI																		
SHPETIM	-	KULLAKSHI																		
VALBONA	-	KULLAKSHI																		
ZAIDE	-	KULLAKSHI																		
2	ALI BUKURIJE	MALIQ	KULLAKSHI	TIRANE	8140	3/317	TRUALL	898	898	0	21	207	66.44	35,199.00	2,338,621.56			2,338,621.56		
	HAMIDE	MALIQ	LLABANI																	
	ZYHRA	ABDULLA	MEMA																	
	SONILA	ABDULLA	KULLAKSHI																	
	ARBEN	MUHAMED	TAGANI																	
EDVANA	MUHAMED	KULLAKSHI																		
ELISABETA	HAMIT	MEHLILI																		
ELIDA	HAMIT	PULA NIKA																		
QEFERE	MALIQ	KALLUSHI																		
3	ALI BUKURIJE	-	KULLAKSHI	TIRANE	8140	3/74	TRUALL	1368.05	1368.05	82.81	20	19	15.47	35,199.00	544,528.53			544,528.53		
	HAMIDE	MALIQ	LLABANI																	
	MUHAMED	-	KULLAKSHI																	
	NAIME	-	ALLAMUCA																	
	QEFERE	-	KULLAKSHI																	
VLERA TOTALE																6.055.283.97				

**VENDIM****Nr. 609, datë 23.10.2025****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”, ndryshohen të dhënat për 2 (dy) individë, të renditur në shkronjën “a”, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

NDRYSHIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-QAIDA*

a) Ndryshimet në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”;

1. *ABD EL KADER: MAHMOUD: MOHAMED: EL SAYED*

2. *ARIS: SUMARSONO*

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

VENDIM**Nr. 610, datë 23.10.2025****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, MASËS, PËRJASHTIMEVE NGA SANKSIONET DHE PROCEDURËS PËR MBLEDHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË INFORMACIONIT TË UDHËTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim përcakton rregullat, masën, përjashtimet nga sanksionet dhe procedurën për mbledhjen dhe administrimin e tarifës, që paguhet nga transportuesit që transmetojnë informacionin e udhëtimit në sistemet e Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit.

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtën kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky vendim zbatohet për të gjithë transportuesit tokësorë, ajrorë dhe ujorë, që operojnë në hyrje, dalje ose transit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 38/2025, “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

II. MASAT, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MBLEDHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TARIFËS

4. Tarifa për transmetimin e informacionit të udhëtimit, për një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është në vlerën 200 (dyqind) lekë për



pasagjer. Pas vitit të parë, vlera e tarifës rishikohet dhe caktohet në vlerë fikse të rishikueshme çdo 3 (tre) vjet.

Të ardhurat nga kjo tarifë përdoren për mbulimin e kostove të transmetimit dhe të transformimit të informacionit të udhëtimit.

5. Tarifa përcaktohet në përputhje me parimet e kostos reale të shërbimit, efikasitetit dhe rishikimit periodik.

Vlera e tarifës përbëhet nga:

a) kostoja e infrastrukturës teknologjike (servera, pajisje sigurie, licenca *software*-ike);

b) kostoja operationale (mirëmbajtje, mbështetje teknike, komunikim me sistemet e transportuesve);

c) kostoja e transferimit të vazhdueshëm të të dhënave të Sektorit i Inteligjencës së Udhëtimit;

ç) kostoja e transformimit të të dhënave dhe përpunimi në formatet e miratuara në rregulloren e përpunimit të të dhënave të udhëtimit;

d) kostoja e sigurisë dhe e auditimit të të dhënave;

dh) kostoja administrative e operatorit ekonomik për të menaxhuar dhe për të përpunuar kërkesat që lidhen me transmetimin ose me transformimin e të dhënave të udhëtimit.

Për rishikimin e tarifës, operatori ekonomik paraqet një raport financiar të detajuar, ku shpjegohen kostot ekzistuese dhe ato të reja, që justifikojnë ndryshimin e tarifës. Raporti financiar i detajuar verifikohet dhe miratohet nga Sektorit i Inteligjencës së Udhëtimit, dhe duhet të përfshijë të gjithë zërat e kostove, përfshirë mirëmbajtjen, sigurinë, licencat, shpenzimet operative, krahasuar me sasinë e të dhënave të transmetuara.

6. Procedura për mbledhjen dhe administrimin e tarifës është, si më poshtë vijon:

a) Transportuesit, brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, paraqesin pranë Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit raportimin e të dhënave për pasagjerët e transportuar në muajin paraardhës;

b) Sektorit i Inteligjencës së Udhëtimit, brenda 5 (pesë) ditëve punë, verifikon dhe konfirmon të dhënat për numrin e pasagjereve dhe ia paraqet këto operatorit ekonomik që do të ofrojë shërbimin e transmetimit dhe të transformimit të informacionit të udhëtimit;

c) Operatori ekonomik, brenda 5 (pesë) ditëve nga konfirmimi i Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit, prodhon dhe i njofton faturën mujore përkatëse çdo transportuesi të detyruar për transmetimin e të dhënave, bazuar në numrin e

pasagjereve dhe për të cilët janë transmetuar të dhënat e udhëtimit;

ç) Një kopje e faturës së prodhuar i dërgohet Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit, së bashku me informacionin lidhur me momentin e njoftimit të faturës transportuesit;

d) Pagesa kryhet nga transportuesi në llogarinë e operatorit ekonomik që do të ofrojë shërbimin e transmetimit të informacionit të udhëtimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit të faturës;

dh) Në rast mospagese të tarifës, sipas afateve të përcaktuara në këtë pikë, zbatohen parashikimet e ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar;

e) Administrimi i tarifës kryhet nga operatori ekonomik që do të ofrojë shërbimin për transmetimin dhe për transformimin e informacionit të udhëtimit, dhe përdoret për qëllimin për të cilin është vendosur tarifa;

ë) Operatori ekonomik ka detyrimin për të siguruar transparencë të plotë në administrimin e tarifës, duke mbajtur të dhëna të sakta dhe të gjurmueshme për çdo pagesë të kryer nga transportuesit ose nga operatorët e tyre përfaqësues;

f) Operatori ekonomik është i detyruar të raportojë çdo tremujor te Sektorit i Inteligjencës së Udhëtimit për numrin e transportuesve të mbuluar, shërbimet e kryera dhe vlerën e përgjithshme të tarifave të arkëtuara. Raportet shoqërohen me dokumentacion mbështetës financiar dhe teknik.

7. Përfshihen nga pagesa e tarifës:

a) pasagjerët nën moshën 2 (dy) vjeç, pa vend të rezervuar;

b) udhëtimet për qëllime humanitare, të konfirmuara nga autoritetet shtetërore;

c) transportet e kryera nga strukturat shtetërore, në funksion të misionëve të posaçme të sigurisë apo të emergjencës.

8. Transportuesit apo operatorët ekonomikë përjashtohen nga zbatimi i sanksioneve të parashikuara në shkronjën “dh”, të pikës 6, të këtij vendimi, në rastet e:

a) defekteve teknike të papritura në sistemet e transmetimit, të provuara dhe të dokumentuara;

b) forcës madhore (fatkeqësi natyrore, gjendje të jashtëzakonshme, të konfirmuara me vendim të organit publik, sulme kibernetike), që e bëjnë objektivisht të pamundur transmetimin;



c) njoftimit paraparak ose të menjëhershëm të problemit dhe bashkëpunimit me Sektorin e Inteligjencës së Udhëtimit për korrigjimin e tij;

ç) korrigjimit të shkeljes brenda afatit të arsyeshëm, kur nuk kanë ardhur pasoja.

III. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 613, datë 23.10.2025

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Arta Dollani, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

